

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

- “Mirëmbajtja e aseteve elektronergjitike (3 vite)”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Sherbime te lidhura me energjitiken 71314000-2

Sherbime te menaxhimit te energjise 71314200-4

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

136.246.114 (njëqind e tidhjetë e gjashtë million e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e katërmbëdhjetë) lekë, pa TVSH / 136.246.114 (njëqind e tridhjetë e gjashtë million e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e katërmbëdhjetë) lekë, pa TVSH./1.429.055,11 (një milion e katërqind e njëzet e nënte mijë e pesëdhjetë e pesë presje njëmbëdhjetë ) Euro pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – **Autoriteti Portual Durrës** – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Ofertuesi, duhet të ushtrojë veprimtarinë e tij në fushën e “Mirmbajtjes, Zbatimit dhe Kryerjes së Shërbimeve të Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Veprave Infrastrukturore Energjitike Industriale dhe Civile të Tensionit të Mesëm dhe të Ulët, Sistemeve të Trajtimit të Ajrit të Kondicionuar, Paisje komandim dhe kontrolli Automatike, UPS, etj. .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

*(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

*Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën, dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar vetëm në rastin kur ato janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të auditorit ligjor dhe kontabël të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme: Shërbime mirëmbajtje të infrastruktures energjitike dhe elektrike, Sistemeve të Trajtimit të Ajrit të Kondicionuar, Paisje komandim dhe kontrolli Automatike, UPS, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së kontratës, në një vlerë jo më pak se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

### **Shënim:**

Sherbime të ngjashme do të konsiderohen, shërbime, mirëmbajtje apo vendosje të pajisjeve objekt prokurimi.

Ne rastin e kontratave furnizim-vendosje, shërbime e ngjashme, do të konsiderohet Vlera e shërbimit, mirembajtjes apo vendosjes së pajisjeve objekt i këtij prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pikat 2 e 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001- 2015 ose e përditësuar (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

*Duke qene se sistemi pjese e prokurimit eshte e rëndesishme per sigurine dhe vijueshmerine e punes te sistemeve kritike ne APD duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.*

*Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është i rëndesishem per te siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë., të ndryshuar.*

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certificate ISO 45001-2018 ose e përditësuar (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certificate ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që plotësojnë kërkesat e cilësisë për realizimin me sukses të kontratës

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certificate ISO 14001-2015 ose e përditësuar (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certificate ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që plotësojnë kërkesat e cilësisë për realizimin me sukses të kontratës

Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me

*standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.*

**2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 50001-2018 ose e përditësuar (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që plotësojnë kërkesat e cilësisë për realizimin me sukses të kontratës*

*Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.*

**2.3.6.** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe

disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

N.P.11 – C Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e Tensionit te Larte T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

**Argumentim:**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore. Nga kjo natyrë pune kërkohet që ofertuesit të jenë të licensuar nga RSH për kryerjen e ketyre punimeve.

N.S.12- A Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.

**Argumentim:**

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi, si dhe janë asete aktualisht të AK për vendosje dhe mirëmbajtje nga OE fitues i kontratës.

N.S.14-A Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

**Argumentim:**

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme, si dhe janë asete aktualisht të AK për vendosje dhe mirëmbajtje nga OE fitues i kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise

kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).

Ne rast të bashkimit të operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet të paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Vendim nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të neneve 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit, këshilli i ministrave*

**2.3.7.** Operatori ekonomik, duhet të ketë në zotërim dokumenta që do të vertetonin se kualifikimet profesionale të tij janë të plota dhe çilesisht në përputhje me llojet dhe specifikat e sistemeve elektrike dhe elektroenergjitike të instaluar në APD dhe që do të mirembahen e riparohen prej tij. Për këtë, ai duhet të prezantojë dokumenta si: licenca/ autorizime/marreveshje partneriteti /certifikata specializimi, të lëshuara operatorit ekonomik ofertues/ose personelit të tij, nga prodhuesit kryesorë të sistemeve të instaluar ose nga distributorët e tyre të autorizuar (në rastin e distributorit të autorizuar duhet të paraqitet dokumenti që verteton lidhjen midis Prodhuesit dhe distributorit), si më poshtë:

1.Pajisjet e rrjeteve energjitike TM

2.Pajisjet e rrjeteve energjitike TU

3.Pajisjet dhe sistemet e trajtimit të ajrit të kondicionuar (Chiller,Kondicioner Spliter)

4.Panelet e kontrollit automatik

5.Paisje UPS

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**2.3.8.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikata/deshmi kualifikimi profesionale të personelit,, të cilat duhet të mbulojnë minimalisht fushat specifike, si me poshte:

- a. Sisteme të mbrojtjes në rrjetat TU dhe TM,
- b. Pajisje të mbrojtjes në rrjetat TU dhe TM,
- c. Sisteme HVAC,
- d. Sitemit të komandimit dhe kontrollit automatke,
- e. Pajisje të ndricimi.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe lidhen ngushtësisht me natyrën e zërave të kërkuar në ToR dhe listën e asetëve për mirëmbajtje të AK.*

**2.3.9.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikata/deshmi kualifikimi profesionale të leshuara nga ana e Prodhuesit, ose distributori i autorizuar për personelin (në rastin e distributorit të autorizuar duhet të paraqitet dokumenti që verteton lidhjen midis Prodhuesit dhe distributorit), në fushat specifike, si me poshte:

- a. Xhunto,
- b. Terminale (koka kablli),
- c. Pajisje të ndricimit,
- d. Çela,
- e. Gjenerator,
- f. Panele fotovoltaike,
- g. Transformator,
- h. Panele TU,
- i. Karikues Makina elektrike,

- j. Impjante te trajtimit te Ajrit,
- k. UPS,
- l. Sisteme HVAC.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe lidhen ngushtësisht me natyrën e zërave të kërkuar në ToR dhe listën e asetëve për mirëmbajtje të AK.*

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë burime njerezore të mjaftueshme dhe cilesisht të kualifikuara, ndaj kërkohet që numri i përgjithshëm i të punësuarve të Ofertuesit në **tre (3) muajt e fundit** deri në momentin e hapjes së procedurës, të jetë jo më pak se **30 (tridhjetë) punonjës** në muaj. Në plotësim të kësaj, kërkohet:

- Një vertetim leshuar nga dega rajonale e tatimeve ose sigurimeve shoqërore e shëndetësore, mbi numrin e punonjësve të siguruar nga operatori për çdo muaj për periudhën e sipërpermendur.
- Listepagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (e-sig/25) të depozituara pranë drejtorisë së sigurimeve shoqërore për periudhën e sipërpermendur dhe të certifikuar prej tyre.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Ky numer i përgjithshëm punonjësish vlerësohet minimal për të garantuar zbatimin si*

*dhe mirembajtjen e suksesshme. Numri i pergjithshem i personelit jo me pak se 30, eshte bere per te garantuar qe operatori ekonomik ka strukturen organizative, eksperiencen si dhe organizimin e duhur per te marre persiper nje ndermarrje te tille..*

2.3.11 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar ne profesionet Inxhinjer per, Zbatimi dhe Mirembajtje të cilët të figurojë në listëpagesa per te pakten tre (3) muajt e fundit, personelin e meposhtem:

- a) 2 (dy) Inxhiniere Drejtues teknike ne Licencen e Shoqerise, me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektrike për drejtimin e të gjitha llojeve të shërbimeve "Zbatues i sistemeve industriale te furnizimit TM\_TU", me eksperience jo më pak se 5 (pese) vjet në fushën e shënuar. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si kontrate e vlefshme pune dhe CV e inxhinjerit,diplomen e inxhinjerit, libreze pune. vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave.
- b) 1 (nje) Inxhinier Drejtues teknike ne Licencen e Shoqerise, me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Mekanik, për drejtimin e të gjitha llojeve të shërbimeve "Zbatues i sistemeve te trajtimit te Ajrit te Kondicionuar "me eksperience jo më pak se 5 (pese) vjet në fushën e shënuar. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si Kontrate e vlefshme pune dhe CV e inxhinjerit,diplomen e inxhinjerit, libreze pune. dhe vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave.
- c) 1(një) Inxhinier Drejtues teknike ne Licencen e Shoqerise, me diplomë master ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet e Inxhinierit Elektronike ,Automatike – Industri , për drejtimin e të gjitha llojeve të shërbimeve " Zbatues i sistemeve te komandimit dhe kontrollit automatik "me eksperience jo më pak se 5 (pese) vjet në fushën e shënuar. Për të vërtetuar plotësimin e kesaj pikës operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë Kontrate te vlefshme pune, CV-në e personelit, diplome, libreze pune, dhe vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme si dhe staf të kualifikuar dhe të profilizuar/certifikuuar sipas natyrës së zërave dhe tipologjisë së ndërhyrjeve objekt procedure për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

**2.3.12.** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 1(një) Inxhinier, i pajisur me Certificate Auditues Energjie ne Ndertesa dhe ne Transport, me eksperience jo më pak se 3 (tre) vjet në fushën e shënuar. per të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë Kontrate te vlefshme pune, CV-në e personelit, diplome, libreze pune, dhe vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme si dhe staf të kualifikuar dhe të profilizuar/certifikuuar sipas natyrës së zërave dhe tipologjisë së ndërhyrjeve objekt procedure për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

**2.3.13.** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 1(një) Inxhinier, i pajisur me Certificate per sistemet BMS (Building management system), me eksperience jo më pak se 3 (tre) vjet në fushën e shënuar, per të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave

Për të vërtetuar plotësimin e ketij kriteri operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë Kontrate te vlefshme pune, CV-në e personelit, diplome, libreze pune, dhe vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do te vertetohet nga deklarimet E\_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**2.3.14.** Operatori ekonomik duhet te kete te punesur **12 (dymbëdhjete) punonjes elektriciste** te certifikuar per nderhyrje te **Grupit te II-V** te Sigurise, te pakten **4 (kater) prej tyre te pisur me grupe sigurie IV-V me arsimin perkates**, percaktuar sipas Dëshmise se kualifikimit te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve. per te pakten 3 (tre) muajt e fundi duke vertetuar nepermjet listpagesave (e-sig/25) te depozituara prane drejtorise se sigurimeve shoqerore per periudhen. Në plotësim të ketij kriteri, Operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si me poshte: listpagesave (e-sig/25) te depozituara prane drejtorise se sigurimeve shoqerore per periudhen, kontrate te vlefshme pune , libreze pune, deshmi profesionale të punonjësve (Certificate/Diplome), deshmi e grupit IV-V te Sigurise

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme si dhe staf të kualifikuar dhe të profilizuar/certifikuar sipas natyrës së zërave dhe tipologjisë së ndërhyrjeve objekt procedure

*për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën Nuk përjashtohet, sipas natyrës, së punimeve që një specialist/inxhinier të jetë i profilizuar apo të disponojë 2 apo me shumë certifikime njëkohësisht sipas kërkesave më sipër.*

2.3.15 Operatori ekonomik duhet te kete te punesur 2 (dy) Punonjes Hidraulik per sistemin Chiller, me arsimin perkates te certifikuar, me Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve. per të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave

Në plotësim të këtij kriteri, operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si me poshte: listpagesave (e-sig/25) te depozituara prane drejtorise se sigurimeve shoqerore per periudhen, kontrate te vlefshme pune , libreze pune, deshmi profesionale të punonjësve (Certifikate/Diplome), deshmi e grupit III te Sigurise

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme si dhe staf të kualifikuar dhe të profilizuar/certifikuar sipas natyrës së zërave dhe tipologjisë së ndërhyrjeve objekt procedure për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën Nuk përjashtohet, sipas natyrës, së punimeve që një specialist/inxhinier të jetë i profilizuar apo të disponojë 2 apo me shumë certifikime njëkohësisht sipas kërkesave më sipër.*

2.3.16 Operatori ekonomik duhet te kete te punesur Te pakten 2(dy) punonjes elektrikist te certifikuar per nderhyrje punime që do të kryhen në Lartësi, me arsimin perkates te certifikuar, me Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve per të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave

Në plotësim të këtij kriteri, operatori duhet të paraqese per secilin punonjes dokumentacionin si me poshte: listpagesave (e-sig/25) te depozituara prane drejtorise se sigurimeve shoqerore per periudhen, kontrate te vlefshme pune , libreze pune, deshmi profesionale të punonjësve (Certifikate/Diplome), Deshmi e grupit III te Sigurise.

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme si dhe staf të kualifikuar dhe të profilizuar/certifikuar sipas natyrës së zërave dhe tipologjisë së ndërhyrjeve objekt procedure për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën Nuk përjashtohet, sipas natyrës, së punimeve që një specialist/inxhinier të jetë i profilizuar apo të disponojë 2 apo me shumë certifikime njëkohësisht sipas kërkesave më sipër.*

Për pikat 2.3.14, 2.3.15, 2.3.16 Ofertuesit e huaj, duhet te beje njesimin certifikatave te punonjesve per nderhyrje sipas grupeve te shenuara me siper, prane ISHTI \_ Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial.

**2.3.17.** Mbeshtetur ne natyren e punimeve dhe sherbimeve te parashikuara duhet qe operatori ekonomik te kete ne stafin e tij të punësuar nje Inxhinier – Auditues Energjie Për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët Ekonomike duhet të paraqesin a) listpagesat e shoqërisë, b) Kontrata e punes (e vlefshme per te paktën periudhen e parashikuar ne mirmbajtje), c). Certifikata (Dip) per auditimin e energjise

**Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.**

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme si dhe staf të kualifikuar dhe të profilizuar/certifikuar sipas natyrës së zërave dhe tipologjisë së ndërhyrjeve objekt procedure për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

**2.3.18.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të punësuar 1 (nje) punonjës që disponon çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Në plotësim të këtij kriteri, Per permbushjen e këtij kriteri duhet të paraqese a) listpagesat e shoqërisë, Kontratë pune të vlefshme, Diplomën/certifikatën përkatëse, Librezë pune.

**Argumentimi:** Në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier

### **2.3.19 Mjete dhe paisje**

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë ne pronesi apo me qera , mjetet sipas tabelës në Shtojcës I, ne dokumentin Shtojcat ngarkuar ne SPE

Për të deshmuar permbushjen e këtij operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten e pronesisë ose kontratën e marrjes me qera sipas rastit, siguracionin e mjetit si dhe fotot perkatëse të mjetit.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të deshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

b)Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë pajisjet sipas tabelës në Shtojcës H, ne dokumentin Shtojcat ngarkuar ne SPE

Për të deshmuar permbushjen e këtij operatori ekonomik duhet te paraqese faturat e shitjes si dhe fotot perkatëse të pajisjes.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.20 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me të cilën të impenjohet se të gjithë punnjesit mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera pergjate periudhes se zbatimit të kesaj kontrate prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

*Argumentimi: Kjo kërkesa garanton menaxhim efektiv të kontratës, koordinim të aktiviteteve dhe minimizim të risqeve gjatë zbatimit.*

**2.3.21** Ofertuesit, në përputhje me kërkesat e shprehura në TeR dhe në dokumentat e tjera të këtij tenderi, duhet të paraqesin dokumentat e mëposhteme:

- a) Planin operacional të detajuar për zbatimin e kësaj Kontrate duke përfshirë metodologjinë, burimet njerezore, makineritë dhe pajisjet dhe sistemin koordinimit dhe menaxhimit.

*Argumentimi: Kërkesa për plan operacional të detajuar justifikohet me nevojën për një organizim të qartë të procesit të punës, metodologjisë së zbatimit, burimeve njerëzore dhe pajisjeve. Ky plan garanton menaxhim efektiv të kontratës, koordinim të aktiviteteve dhe minimizim të risqeve gjatë zbatimit.*

- b) Planet paraprake të mirembajtjes së aseteve dhe instalimeve energjitike; SHTOJCA\_J - LISTA E SISTEMEVE DHE PAJISJEVE, për të cilat ofertuesit duhet të paraqesë programin e mirembajtjes sipas TeR.

*Argumentimi Përcaktimi i planeve paraprake të mirëmbajtjes së aseteve dhe instalimeve energjitike është thelbësor për sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të sistemeve. Kjo kërkesë synon të garantojë qasje parandaluese dhe korrigjuese të mirëstrukturuar, duke reduktuar defektet dhe kostot operative.*

- c) Strukturën organizative për zbatimin e kësaj kontrate, me pozicionet perkatese, në të cilin të jehë deklaruar dhe të përfshirë të paktën katër personat kryesorë të operatorit, të prezantuar nga ofertuesi në seksionin III Burimet Njerëzore dhe Kualifikimet Profesionale të Tyre pika 3.

*Argumentim: Kërkesa për strukturë organizative dhe përfshirjen e të paktën katër personave kryesorë justifikohet me nevojën për një menaxhim profesional të kontratës. Kjo siguron ndarje të qartë të përgjegjësisë, mbikëqyrje teknike të specializuar dhe aftësi vendimmarrëse në të gjitha fazat e zbatimit.*

- d) Planin e detajuar të investimit për 3 vitet e zbatimit të kontratës.

*Argumentimi: Plani i investimit është i domosdoshëm për të garantuar që operatori ekonomik ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitet për të mbështetur zbatimin afatgjatë të kontratës. Ai reflekton aftësinë për të siguruar pajisje, teknologji dhe përmirësime të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së kontratës.*

- e) Disponueshmëri të mjeteve, Makineri, Pajisje, set vegla pune sipas listës të shënuara nga Autoriteti Kontraktor, Shtojca, bashkëgjatur, të cilën ofertuesi duhet ta plotësojë me sasitë modeli.

*Argumentimi: Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon infrastrukturën teknike të nevojshme për realizimin e punimeve. Pajisjet dhe mjetet e përshtatshme janë element thelbësor për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të shërbimeve.*

**Argumentim:** Argumentim i përgjithshëm për kërkesat teknike dhe organizative të kontratës

*Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kritere të lidhura me kapacitetin teknik, profesional dhe organizativ të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e zbatimit të suksesshëm të kontratës.*

*Kërkesat e parashikuara në pikat a–f lidhen drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe volumet e punimeve/shërbimeve objekt kontrate dhe synojnë të sigurojnë që operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme për realizimin e saj në përputhje me standardet teknike, afatet kohore dhe kërkesat e cilësisë.*

## **II. Argumentimi i termave te references**

Shënim: Përcaktoni termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në termat e references, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- **Nuk lejohet nenkontraktimi dhe nuk lejohet mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera. Pasi eshte sherbim mirembajtje 3 vjecare dhe jo kontrate furnizimi mallrash)**
- **Kjo procedurë është teknikisht e pamundur të ndahet në kontrata të ndryshme sepse, nga vete objekti dhe natyra e prokurimit, kemi të bëjmë me një shërbim mirëmbajtjeje periodike të infrastrukturës, në të gjithë ambientet e APD-së. Autoriteti Kontraktor gjykon se ndarja në lote e kontratës së mësipërme nuk është praktike, pasi zërat e punimeve janë të lidhur ngushtë me njeri tjetrin. Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave, mirëmbajtjen e vazhdueshme të infrastrukturës, duke e ndërlikuar realizimin me sukses të kontratës, brenda periudhës së përcaktuar.**
- **Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht, si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete**

**publikë, t'i certifikojnë ato me vulën “Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për “Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.**

**Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.**